

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për statusin e dëshmorit të atdheut” synon ndryshimin në formë dhe përmbajtje të ligjit aktual në fuqi nr.8607, datë 27.04.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar pasi gjatë zbatimit në praktikë të tij ka lindur nevoja për shtesa dhe ndryshime thelbësore.

Qëllimi i projektligjit është shpallja ose njohja e statusit “Dëshmor i Atdheut” personave, të cilët, me akte të rralla patriotizmi, vetëmohimi dhe heroizmi të jashtëzakonshëm, kontribuan në luftën për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar të Shqipërisë deri në dhënien e jetës, si dhe të personave, që kanë dhënë e japin jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, të interesave kombëtare shqiptare dhe në luftën kundër terrorizmit, krimit ndaj jetës së individit, mbrojtjes së pronës publike, si dhe në raste fatkeqësish natyrore, në ndihmë të popullsisë

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, si dhe të drejtat dhe përfitimet që rrjedhin nga ky status.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve për Ministrinë e Mbrojtjes, për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj është i domosdoshëm, pasi do të përcaktojë kriteret dhe

procedurat për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe të drejtat dhe përfitimet që rrjedhin prej tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS E BE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Statusi “Dëshmor i Atdheut” është rregulluar nëpërmjet ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij ligji bëhej e mundur ngritja dhe funksioni i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” dhe përcaktoheshin kriteret që duhet të plotësoheshin dhe procedurat që duhet të zbatoheshin për marrjen e Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Megjithatë, duke qenë se ligji nr. 8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar është hartuar para 18 vitesh, gjatë implementimit në praktikë të tij ka lindur nevoja për disa ndryshime thelbësore, që nga kriteret dhe procedura e ndjekur për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, e deri tek e drejta e ankimit për vendimet e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Sa më sipër, ky projektligj synon zgjidhjen e problematikave që janë evidentuar gjatë zbatimit 18-vjeçar të tij.

Nëpërmjet këtij projektligji, ndër të tjera, janë bërë ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Janë zgjeruar kriteret që duhet të plotësohen për shpalljen apo njohjen e Statusit “Dëshmor i Atdheut”.
2. Janë përjashtuar nga dhënia ose njohja e statusit “Dëshmor i Atdheut”,

personat që janë dënuar me vendime gjykatë të formës së prerë, për krime kundër njerëzimit, për bashkëpunim me pushtuesit e vendit, për veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë si dhe për vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945.

3. Është zgjeruar lista e dokumenteve që janë të vlefshme për të kërkuar shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”.
4. Është zgjeruar dhe rrethi i autoriteteve publike (shtuar dhe Këshillin Bashkiak) ku mund të bëhet kërkesa nga familjarët për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, kjo për t’u ardhur në ndihmë familjarëve të dëshmorëve.
5. Po ashtu, për të përshpejtuar procedurën, ndër subjektet që mund të kërkojnë shpalljen e një personi “Dëshmor i Atdheut” është shtuar dhe institucioni i “Ministrit”, i cili nënkupton ministrin përgjegjës të institucionit ku ka shërbyer personi që kërkohet të shpallet “Dëshmor i Atdheut”. Gjithësesi, iniciativa e tyre është e kufizuar vetëm për disa raste (kryesisht kur personi që kërkohet të shpallet “Dëshmor i Atdheut” ka rënë për shkak të kryerjes së detyrave ushtarake ose policore).
6. Janë rishikuar disa dispozita, duke përmirësuar mënyrën e nderimit të “Dëshmorëve të Atdheut” si dhe mënyrën e menaxhimit të Varrezave të Dëshmorëve dhe të objekteve në nderim të tyre.
7. Është parashikuar mbështetja dhe nxitja e veprimtarive të organizatave, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre Dëshmorët e Atdheut.
8. Së fundmi, në lidhje me familjen e Dëshmorit të Atdheut, janë bërë disa ndryshime, të cilat mundësojnë zgjerimin e rrethit familjar për efekt nderimi (jo për trajtim financiar), duke shtuar prindërit e prindërve, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen, njerkun/njerkën, thjeshtri/thjeshtren, si dhe nipërit dhe mbesat e dëshmorëve të atdheut.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohen Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, këshillat e qarqeve, këshillat bashkiak dhe prefektët.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk synon ndryshimin e trajtimit financiar të familjarëve të dëshmorëve të atdheut e për pasojë nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

Familjet e dëshmorëve të atdheut do të vijojnë të përfitojnë të njëjtin trajtim financiar dhe të kenë të njëjtat përfitime si me ligjin aktual në fuqi.

KËSHILLI I MINISTRAVE